

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: CI-855/L

Data/Datum/Date: 01/02/2021

Shtojca/Dodaci/Annex: (Rezer)

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.27/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Djellza Hoxha dhe Myjesere Mujku, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbarimore në çështjen përmbarimore P. nr 2594/19, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesi privat, dhe pas seancës këshillimore, me datën 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-27/2020, datë 23.11.2020, dhe ankesa e palës ankuese, të datës 11.11.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 2594/19.

Arsyetim

Me datën 11.11.2020, pala ankuese paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat si organ përmbaues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore për shkak se i njëjti ka kryer një varg shkeljes disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore në lëndën P. nr 2594/19. Pala ankuese pretendon që përmbauesi ka lëshuar urdhër bankare të debitorit në të cilën ky i fundit realizon pensionin invalidor dhe ka rrezikuar ekzistencën e tij dhe familjes. Përmbauesi privat ka kufizuar mjetet në llogarinë bankare me shumë se gjysma e lartësisë së tyre, në kundërshtim 112 të LPP-së. Tutje, përmbauesi privat ka bërë deblokimin e llogarisë përkohësisht pas ankesës nga pala ankuese por pastaj përsëri është bllokuar llogaria.

Përmbauesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Specifikisht lidhur me bllokimin e llogarisë bankare, përmbauesi privat thekson që pasi që është bërë urdhëri për përmbaimit i formës së prerë është vazhduar me bllokimin e llogarisë bankare. Me datën 23.03.2020 kishin pranuar një korrespondencë elektronike nga djali i palës ankuese, i cili iu ka kërkuar informacion rreth bllokimit të llogarisë bankare dhe deblokimit të llogarisë në mënyrë që t'i mundësohet prindit të tij tërheqja e pensionit. Përmbauesi privat thekson që të nesërmen e kishte njoftuar atë se pala ankuese mund të tërheq pensionin deri në shumën prej njëqind e tetë dhjetë (180) euro, dhe se banka ua kishte konfirmuar këtë. Meqenëse të ardhurat e debitorit nuk e tejkalojnë shumën më të lartë të ndihmës sociale në vlerë prej 180 euro (shumë e përcaktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të dt 20.01.2018), sipas përmbauesit, debitorëve që pranojnë të ardhura nën këtë shumë iu mundësohet tërheqja e tyre në tërësi. Llogaritë bankare vazhdojnë të mbesin të bllokuara për të ardhura tjera që debitorët mund të kenë deri në përmbushjen e obligimit të kreditorit. Rrjedhimisht, përmbauesi propozon refuzimin e ankesës.

Me datën 25.01.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimit Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore dhe përmbauesit privat, .. Pala ankuese nuk ka prezantuar përkundër që ka qenë e njoftuar me kohë.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimit Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përmbauesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit.

Komisioni Disiplinor, gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar provat në vijim: konkluzionin për bllokimin e llogarive bankare date 04.10.2019; komunikimet elektronike mes përmbauesit dhe djalit të palës ankuese; propozimin për përmbaimit të datës 13.09.2019; urdhrin për përmbaimit i të datës 16.09.2019; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës

12.01.2018: komunikimet elektronike mes përmbauesit privat dhe zyrtares së bankës NLB, znj Lumnije Gashi.


Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbauesi privat nuk ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen të pabazuar ankesën e palës për sa i përket asaj që përmbauesi privat ka ndërmarr veprime të ngutshme duke bllokuar llogarinë bankare të palës ankuese, në të cilën ky i fundit realizon pensionin invalidor dhe ka rrezikuar ekzistencën e tij dhe familjes. Gjithashtu, Komisioni gjen të pabazuar pretendimin se përmbauesi privat ka kufizuar mjetet në llogarinë bankare më shumë se gjysma e lartësisë së tyre, në kundërshtim 112 të LPP-së. Djali i palës ankuese, me datën 23.03.2020 kishte kërkuar informacion nga përmbauesi privat, siç edhe evidentohet në korrespondencat elektronike. Në këto korrespondenca konstatohen bisedit mbi bazën e të cilave vërtetohet se përmbauesi privat i kishte ofruar gjithë informacionin e nevojshëm palës ankuese. Po ashtu përmbauesi privat kishte komunikuar me zyrtarin e Bankes dhe ishte siguruar që palës ankuese i lejohet tërheqja e pensionit deri në gjysmën e shumës.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se përmbauesit privat nuk kanë diskrecion për të zbatuar procedurën përmbaimore. Ata obligohen të zbatojnë procedurën përmbaimore mbi bazën e propozimit të palës kreditore kur plotësohen kushtet ligjore. Këtë kishte bërë përmbauesi privat në rastin konkret pasi urdhëri përmbaivor ishte i formës së prerë. Nëse pala ankuese konsideron se të drejtat e tij afektohen në mënyrë të padrejtë, ato pretendime pala mund t'i adresoj në gjykatën kompetente përmes mjeteve juridike në dispozicion. Procedurat disiplinore pranë këtij komisionin nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palët adresojnë pretendimet ligjore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 27/2020, datë 25.01.2021


Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.